



01Nr. 104/02-11918 /26
Kačanik, 21.05.2026

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt -Propozimeve të OJQ-ve

Komuna e Kaçanikut, sipas Thirrjes Publike 03Nr.104/02-11084/26 e datës 13.05.2026, për aplikim për subvencione në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2026, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare në fushat prioritare që ndërlidhen me zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.

- Sipas Thirrjes publike 01Nr.104/02-11369/26 e datës 15.05.2026, për aplikim për subvencione për OJQ që trajtojnë fushat si : mbështetjen sociale dhe familjare për grupet në nevojë, ofrimin e kujdesit, këshillimit, avokimit dhe mbështetjes psiko-sociale, përkujdesjen ndaj veteranëve, invalidëve të luftës, familjeve të dëshmorëve, martirëve dhe kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, organizimin e aktiviteteve përkujtimore, edukative dhe sensibilizuese, promovimin dhe ruajtjen e vlerave të luftës së UÇK-së dhe trashëgimisë së saj historike, si dhe aktivitetet që forcojnë solidaritetin shoqëror, kujtesën institucionale dhe përfshirjen e komunitetit në mbështetje të këtyre kategorive.

- Sipas Thirrjes Publike 01Nr.104/02-11372/26 e datës 15.05.2026, për aplikim për subvencione për OJQ që trajtojnë njëri ose më shumë nga fushat që lidhen me mbrojtjen e ambientit/mjedisit, ndërgjegjësimin e qytetarëve për ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e hapësirave publike, promovimin e praktikave të gjelbra, si dhe ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete që ndikojnë në krijimin e një ambienti më të pastër, më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm për qytetarët e komunës së Kaçanikut.

Rregullorja MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësueses për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, si dhe rregullores Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Për këtë qëllim, Komuna e Kaçanikut, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projekt -propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 1 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 1 vite përvojë pune ;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;

Aplikimi mund të bëhet nga data 22.05.2026 deri më datë 01.06.2026 duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 8)

Komuna e Kaçanikut, do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike, do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese sipas thirrjeve publike që do të bëjë Komuna e Kaçanikut në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë vitit 2026.



Kryetari i Komunës
Sabedin Vishi